



485  
20.04.2026  
REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2135/1 Prot.

Elbasan, më: 20.04.2026.

V E N D I M

Nr. 52 Datë: 20.04.2026.


*“Për një saktësim në pikën 1, V.K.B nr. 40, datë 27.03.2026 “Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan””.*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 20.04.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike :

V E N D O S I :

1. Miratimin e saktësimit të pikës 1 të VKB nr.40 dt 27.03.2026 me riformulimin si më poshtë : “*Miratimin për fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr. 3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan, për t’u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik për ndërtimin e një pike grumbullimi për produkte agroushqimore dhe ndërtimin e serave për prodhime bujqësore”.*
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI  
Lutfi Lala



SEKRETARI  
Elsid Zyma

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.U:

Drejtoria D.P.P.D.U:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J. I:

Zw/Kryetar:

G. Kerri A. Pisha

G. Dyrmyshi

A. Merkjo

M. Avllazagaj

K. Haxhihyseni

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasnika

Miratuar me 31 vota

Vota Pro 30

Vota kundër 1

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 20 / 04 / 2026

2135/2.  
20.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 4837<sub>1</sub> Prot.

Elbasan më 20 04 . 2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.52, datë 20.04.2026, "Për një saktësim në pikën 1, V.K.B nr.40, datë 27.03.2026 'Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr.4 dhe nr.8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan'" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





503

28.03.2026



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2197/1 ProtElbasan më 28 /03/2026

## VENDIM

Nr 53 datë 28/03/2026.**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MARS 2026**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_/03/2026

## VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MARS 2026, 78 familje me fond 240.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar me 37 votaPro 35Kundër 0Abstenim 0

2197/2

04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 503/11 Prot

Elbasan, më 4.5.2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.53, datë 28.04.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Mars 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



5704

29-04-2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2198/1 Prot

Elbasan më 29/04 2026

VENDIM

Nr. 54 datë 28/03/2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi ikushtëzuar për muajin MARS 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_/03/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **MARS 2026** për 249 familje me një fond prej **1.163.187** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Miratuar me 37 vota


Pro 35

Kundër 0

Abstenim 1

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



2138/2  
04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 504/1 Prot

Elbasan, më 04.5.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.54, datë 28.04.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





525  
29.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2214/1 Prot.

Elbasan, më 29.04.2026

VENDIM

Nr. 55, datë 28/04/2026

PËR

“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË ELBASAN NË PROGRAMIN E MËSIMIT NËPËRMJET BINJAKËZIMIT COHORT 4 DHE MIRATIMIN E MARËVESHJES SË BINJAKËZIMIT”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28/04/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Elbasan në Programin e Mësimit nëpërmjet Binjakëzimit Cohort 4.
2. Të miratojë Marrëveshjen e Programit të Mësimit nëpërmjet Binjakëzimit Elbasan- Paredes dhe partneritetin mes palëve si edhe buxhetin e parashikuar.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve dhe Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Monitorimit dhe Statistikës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: Pergi.S.P.100 qytetet A.Hodaj  
D.D.I.E.P.I: E.Çuni  
D.P.B.P.M.S.P: L. Haxhiymeri  
Pranoi: D.B.F: A. Merkja  
D.Juridike: A. Hoxha  
Miratoi: Zv/ Kryetare: K. Krasnika

Sekretari i Keshillit Bashkiak

Elsid ZYMA

Kryetari i Keshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Miratuar me 37 vota  
Pro 28  
Kundër 0  
Abstenum 6

2214/2  
04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 5057 / Prot.

Elbasan më 4.5. 2026


Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.55 datë 28.04.2026 “Për miratimin e e pjesëmarrjes se Bashkisë Elbasan në programin e mësimin nëpërmjet Binjakëzimit COHORT 4 dhe miratimin e Marrëveshjes së Binjakëzimit” konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.


**PREFEKTI**

**Hir BEJTJA**





506  
29.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

dt. 29.04.2026

Ue. 2193/1 Prot

## V E N D I M

Nr. 56 datë 28.04.2026

### "PËR MIRATIMIN E THEMELITIT TE SHOQËRISE TREGTARE "ERE" SH.A, SI PERSON JURIDIK NE PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN DHE MIRATIMIN E AKTEVE TË THEMELITIT"

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me Miratimin e themelimit te shoqërisë tregtare "ERE" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Elbasan dhe miratimin e akteve të themelimit, në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", i ndryshuar;
- Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36
- Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.
- Ligji nr.9734, date 14.05.2007 "Për Turizmin",.

## V E N D O S I

1. Krijimin e shoqërisë tregtare "ERE" sha, në formën e shoqërisë tregtare aksionare, me objekt objekt ushtrimin e veprimtarive ekonomike në funksion të zhvillimit rural, mjedisor dhe agroturistik.
2. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit te shoqërisë " ERE "sha.a si dhe të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaj aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
3. Shoqëria " ERE " sh.a, themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri me aksione, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë " ERE " sha do të jetë 5.000.000 (pesë milion) lekë.
5. Transferimin e fondit 5,000.000 lekë. në buxhetin e vitit 2026, nga DPKS, funksioni 08230, artikulli 602 "Festat e Njësisve Administrative", në funksionin 04220, artikulli 604, institucioni Bashkia, për financimin e pikës 4, të këtij vendimi.
6. Bashkia Elbasan është ortaku i vetem themelues, i cili zotëron 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë "ERE".
7. Shoqëria " ERE " sha, te ketë selinë qendrore në adresën.", Rruga Qemal Stafa (Godina e Bashkisë).
8. Shoqëria "ERE "sha, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.
9. Bashkia Elbasan, brenda 15 (pesëmbdhjete ) diteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë " ERE "sha.
10. Shoqëria " ERE " sha, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëritë e tjera tregtare dhe të hyje në marrënie kontraktuale me persona te tretë.
11. Të autorizojë kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Elbasan, në cilësinë e aksionarit të vetëm përkryrjen e të gjitha veprimtarive të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin të akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

12. Bashkia Elbasan i siguron shoqerise "ERE " sha, nga inventari i saj i pronave të paluajjtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
13. Bashkëngjitur relacioni shpjegues.
14. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
15. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma**

Konceptoi: *L.Baho*

Pranoi: *L.Haxhiymeri*

Miratoi: *Sh.Çullhaj*

Nenkryetar: *A.Sula*

D. Finances: *A.Merkja*

D. Juridike : *A.Hoxha*

**KRYETAR**

**Lutfi Lala**

Miratuar me 37 vota

Vota Pro 29

Vota Kundër 4

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 29/04 2026

21.93/2  
05.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 506/Prot.

Elbasan më 05.05.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.56, datë 28.04.2026, "Për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare 'ERE' sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Elbasan dhe miratimin e akteve të themelimit" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





507  
29.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Ur. 2249/1 Prot

**V E N D I M**

Dt. 29.04.2026

Nr. 57 datë 28.04.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”**

Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar; ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 30 pika 4/c, i ndryshuar; VKM nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 290, datë 30.04.2004 “Për Miratimin Strategjik Kombëtar dhe Menaxhimin e Zjarreve në Pyje e Kullota”; VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për Rregullat në Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota si dhe për krijimin e Njësave Vullnetare të Shuarjes së Zjarreve”; VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar të bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatimin e ketij vendimi Drejtoria MNZSH së, Agjencia e Shërbimëve Publike Rurale, Agjencia e Emergjencave Civile, Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale (ASHPR).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

KRYETAR

Lutfi Lala

Konceptoi: H. Idrizi

Pranoi: A. Muça

Miratoi: L. Haxhiymeri

Konfirmoi: Sh. Cullhaj

Miratuar me 37 vota gjithsej

Vota Pro 32

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 29/04 2026

2249/2  
04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 507/1 Prot.

Elbasan, më 04.5.2026

Lënda: Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa: Lagjja "Br.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 57 datë 28.04.2026 "Për miratimin e planit të parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në Fondin Pyjor Kombëtar, bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**  
**Ilir BEJTJA**





507  
28.04.2026  
REPUBLICA E SHQIPËRISE  
SEKRETARIA  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 214/1 Prot.

Elbasan, më: 29.04.2026.

V E N D I M

Nr. 58 Datë: 28.04.2026.

*“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrë Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.*


Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.04.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e procedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi i projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrë Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala



SEKRETARI

Elsid Zyma

Konceptoi: A. Braneshi  
Drejtoria P.P.S:  
Drejtoria F.B.:  
Drejtoria P.U: E. Mihali  
Drejtoria D.P.P.D.U:  
Drejtoria P.Sh.M:  
Drejtoria J. I:  
Zv/Kryetar:

G. Kerri  
G. Dyrmyshi  
P/A. Merkja  
M. Avllazogaj  
K. Haxhihyseni  
S. Mehmeti  
A. Hoxha  
K. Krasnika

Miratuar me 37 vota

Vota Pro 32

Vota kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 29 / 04 / 2026

2114/2

04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 5087 prot.


Elbasan, më 4.5.2026

Lënda: Konfirmim akti


**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.58 datë 28.04.2026 “Për miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrit Kallajxhiu”, ndodhur në zonën kadastrale 8522”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**



**Ilir BEJTJA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr. 2961/Prot

Datë 29.04.2026

**VENDIM**

Nr. 59 Datë 28.04.2026

**“Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR.”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, ”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,”

Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr. \_\_\_\_\_ datë: \_\_\_\_\_

**VENDOSI :**

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AB552YN	Makinë Pastrimi(DAF LF210) Nr.shasisë: XLRAEL1500L466156 Viti prodhimit 2017	4 Litra/orë pune	Gazoi L D1

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale \_.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema  
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi: Drejtor Drejtorie/ Klaudio Tusha  
Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm/ Altin Cenolli  
Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**ELSID ZYMA**

Miratuar me 37 vota

Pro 29

Kundër 1

Abstenim 3

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**LUTFI LALA**

2196/2  
05.05.2026



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 509/1 Prot.

Elbasan më 05.05. 2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.59, datë 28.04.2026, "Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.16, datë 29.01.2025 'Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorike në administrim të ASHPR'" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 21691 Prot.

Elbasan 29.04.2026

VENDIM

Nr. 60 datë: 28.04.2026

**“Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore (Sektori i Promovimit të Turizmit), “Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”, mbështetur në nenin 17 të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), Ligj. Nr. 93/2015 “Për Turizmin” i përditësuar, në Republikën e Shqipërisë”


**VENDOSI:**

1. Miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
Elsid ZYMA

Konceptoi:

Përgjegjëse E.Krraba  
Drejtori DPTTK A.Guni  
Drejtori DPZHEKT A.Canaj  
Drejtorja Juridike: A. Hoxha



Miratuar me 37. vota  
Pro 31  
Kundër 0  
Abstencim 2

2160/4  
03.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK


Nr. 510/3 Prot.

Elbasan më 3.6. 2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.60, datë 28.04.2026, "Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj-Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti 'Krushevo and Elbasan-Journey in Nature and Adventure' (Grant No. 2025/487-660)" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2229/Prot.

Elbasan më 29.04.2026

**VENDIM**

Nr 61 Datë 28.04.2026

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË BILETËS SË FISKALIZUAR DHE  
BILETËS ELEKTRONIKE NË TRANSPORTIN PUBLIK QYTETËS DHE  
RRETHQYTETËS**

***Në mbështetje të:***

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar;
- Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar;
- Vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar;
- Udhëzim nr. 3743, datë 10.7.2017 " Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve ", të ndryshuar;
- Udhëzim nr. 16, datë 3.4. 2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit ";
- Udhëzim nr. 24, datë 16.6.2020 "Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike ";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Akteve nënligjore në fuqi në fushën e fiskalizimit dhe transportit publik;

**Neni 1**

**Objekti**

Ky vendim ka për objekt miratimin e përdorimit të:

- biletës së fiskalizuar;
- biletës elektronike (digjitale);

në shërbimin e transportit publik qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, me qëllim rritjen e transparencës, përmirësimin e shërbimit dhe modernizimin e sistemit të biletimit.

**Neni 2**

Autoriteti dhe roli i Bashkisë

1. Bashkia, si autoritet përgjegjës për planifikimin, organizimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të transportit publik në territorin e saj administrativ, ka të drejtë të projektojë, zbatojë dhe administrojë sisteme dhe infrastrukturë teknologjike në funksion të biletimit dhe monitorimit të shërbimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet kontraktimit të subjekteve të treta.
2. Në ushtrim të këtyre kompetencave, Bashkia përcakton dhe miraton sistemin e biletimit që zbatohet në shërbimin e transportit publik urban, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike përkatëse.
3. Bashkia siguron mbledhjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me funksionimin e shërbimit, përfshirë në veçanti:
  - shitjen e biletave;
  - fluksin e udhëtarëve;
  - respektimin e orareve dhe treguesit e performancës së shërbimit.
4. Operatorët e transportit janë të detyruar:
  - të zbatojnë sistemin e biletimit të miratuar nga Bashkia;
  - të kryejnë shitjen e biletave dhe administrimin e të ardhurave që rrjedhin prej tyre;
  - të zbatojnë kërkesat ligjore për fiskalizimin;
  - të sigurojnë transmetimin në kohë dhe në formatin e kërkuar të të dhënave drejt sistemit të Bashkisë.
5. Bashkia ushtron funksionin e monitorimit dhe analizës së shërbimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura, pa ndërhyrë në administrimin financiar të operatorëve, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në legjislacionin në fuqi ose në marrëveshjet kontraktore.

### **Neni 3**

#### **Fiskalizimin i biletave**

1. Çdo biletë e shitur në transportin publik qytetës dhe rrethqytetës duhet të jetë e fiskalizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Sistemet e përdorura nga operatorët duhet të garantojnë:
  - fiskalizim real të transaksioneve;
  - funksionim edhe në kushte offline, me raportim të mëvonshëm sipas rregullave në fuqi.

### **Neni 4**

#### **Biletimi elektronik**

1. Lejohet përdorimi i biletave elektronike në forma të ndryshme, përfshirë por pa u kufizuar në:
  - karta elektronike Smart/NFC, (Pika 5 e udhëzimit nr. 3743, datë 10.7.2017 të ndryshuar);

- bileta me kod elektronik (p.sh. QR);
  - aplikacione mobile dhe forma të tjera digjitale.
2. Sistemet e biletimit elektronik duhet të mundësojnë:
- gjurmueshmërinë e biletës;
  - verifikimin e vlefshmërisë së saj;
  - kontrollin në terren nga strukturat përkatëse.

## **Neni 5**

### Qëllimi dhe përfitimet

Ky vendim synon:

- nxitjen e digjitalizimit të shërbimit të transportit publik;
- rritjen e transparencës, reduktimin e abuzimeve dhe informalitetit;
- përmirësimin e kontrollit mbi zbatimin e tarifave dhe orareve;
- krijimin e një baze të dhënash për analizë dhe planifikim të politikave të transportit.

## **Neni 6**

### Zbatimi i standardeve ligjore

1. Përcaktimet teknike për biletat dhe sistemet e biletimit elektronik zbatohen në përputhje me:
  - Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 08.02.2017;
  - udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për transportin nr. 3743, datë 10.7.2017;
  - legjislacionin tatimor në fuqi.
2. Operatorët janë të detyruar të respektojnë këto standarde në implementimin e sistemeve të tyre.

## **Neni 7**

### Akte zbatuese

Bashkia, kur është e nevojshme, miraton akte të veçanta për:

- mënyrën e raportimit të të dhënave;
- kërkesat minimale funksionale të sistemeve;
- organizimin e monitorimit dhe kontrollit.

## **Neni 8**

## Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe publikimit sipas legjislacionit në fuqi.


**Sekretari**  
Elsid Zyma

Konceptoi:  
K.Çekrezi,  
D.Celibashi  
A.Canaj  
D.Juridike: A.Hoxha



**KRYETARI**

Lutfi Lala



Miratuar me 37 vota  
Pro 33  
Kundër 0  
Abstencim 1

2225 / 2  
04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 511/ prot.

Elbasan, më 4.5.2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.61 datë 28.04.2026 “Për miratimin e përdorimit të biletës së fiskalizimit dhe biletës elektronike në transportin publik qytetës dhe rrethqytetës”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





572  
29.04.2026  
Nr. 2228/1 Prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
Këshilli Bashkiak

Elbasan, më 29.04.2026

VENDIM

Nr. 62, datë 28/04/2026

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR  
ANËTARËSIMIN E BASHKISË NË PLATFORMËN ‘RRJETI I QEVERISJEVE  
VENDORE PËR QËNDRUESHMËRI (ICLEI).”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28/04/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI :

1. Të miratojë: Në parim marrëveshjen për antarësimin e institucionit në platformën: ‘Rrjeti i Qeverisjeve Vendore për Qëndrueshmëri (ICLEI).’
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan si: Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve, Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Transportit dhe Drejtoria e Buxhet Finances.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: P.S.P.D

K.Kreka

D.S.F

O.Shehu

P.S 100 qyteteve

A.Hodaj

Pranoi:

D.D.I.E.P.I

E.Çuni

D.D.F.B

P/A.Merkja

D.ZH.S.T

A.Canaj

D.D.J

A.Hoxha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Miratuar me 37 vote  
Pro 33  
Kundër 0  
Abstenim 0

2228/2  
05.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 512/ Prot.

Elbasan më 05.5. 2026


Lënda: Konfirmim akti


**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.62, datë 28.04.2026, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për anëtarësimin e Bashkisë në platformën ‘Rrjeti i Qeverisjeve Vendore për Qëndrueshmëri (ICLEI)’ ” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2268/1 Prot.

Datë 29 .04.2026

VENDIM

NR. 63 DATE 28 . 04. 2026

MBI

“Ndryshim financimi në periudhën afatmesme 2027-2028”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28 .04.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Ndryshim financime në periudhën afatmesme 2027-2028”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, “Udhëzimin plotësues nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, si dhe VKB nr.36, datë 27.03.2026,

VENDOSI

1. Miratimin e ndryshimit të fondeve në periudhën afatmesme 2027-2028, nga të ardhurat, për financimin e objekteve për investime, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, mbështetur në tavanet përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, miratuar me VKB nr.42, datë 27.02.2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe ASHPU.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja

DPSHM : S. Mehmeti

Dr.Juridike: A.Hoxha

SEKRETAR

Elsid Zyma

KRYETAR

Lutfi Lala

Miratuar me 37 vota.  
Pro 28  
Kundër 0

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr “Qemal Stafa”, Tel. +355 54 400152, E-mail [bashkiaelbasan@elbasani.gov.al](mailto:bashkiaelbasan@elbasani.gov.al) web: [www.elbasani.gov.al](http://www.elbasani.gov.al)

Abstencim 4

"Ndryshim financiarimi në periudhën afatmesme 2027-2028"

PAKSIME :

ne leke

Gr	Progr.	Funks.	Produkt	Kap	Art	Kodi instit	Institucioni	Shuma/2026	2027	2028	Total
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Ndertimi i rruges se re nga Rotonda e varrezave deri ne intersektimin me rrugen "Nos Josifi", Lagja "Emin Matraxhiu" (finacim 2026-2028, vlera e projektit =64,900,688 leke)	ASHPU	12,900,688	26,000,000	26,000,000	64,900,688
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " " " "	ASHPU	564,894			564,894
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " " " "	ASHPU		84,734		84,734
00	AC109	04520	V452AAC	5+1	231	"Rivitalizimi Urban i shesheve ne aren veriore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori" (finacim 2026-2028, vlera e projektit = 76,583,497 leke ) (financ te arch + gr perform.)	ASHPU	9,291,362	31,000,000	30,000,000	70,291,362
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " " " "	ASHPU	816,230			816,230
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " " " "	ASHPU		122,435		122,435
<b>Totali :</b>								<b>23,573,174</b>	<b>57,207,169</b>	<b>56,000,000</b>	<b>136,780,343</b>

SHTESA:

ne leke

Gr	Progr.	Funks.	Produkt	Kap	Art	Kodi instit	Institucioni	Shuma/2026	2027	2028	Total
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Ndertimi i rruges se re nga Rotonda e varrezave deri ne intersektimin me rrugen "Nos Josifi", Lagja "Emin Matraxhiu" (finacim 2026-2028, vlera e projektit =64,901,089 leke)	ASHPU	12,901,089	26,000,000	26,000,000	64,901,089
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " " " "	ASHPU	606,846			606,846
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " " " "	ASHPU		72,821		72,821
00	AC109	04520	V452AAC	5+1	231	"Rivitalizimi Urban i shesheve ne aren veriore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori" (finacim 2026-2028, vlera e projektit = 90,276,659 leke ) (financ te arch + gr perform.)	ASHPU	8,955,444	38,029,080	37,000,000	83,984,524
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " " " "	ASHPU	1,109,795			1,109,795
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " " " "	ASHPU		113,175		113,175
<b>Totali :</b>								<b>23,573,174</b>	<b>64,215,076</b>	<b>63,000,000</b>	<b>150,788,250</b>



2268/2  
05.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 513/1 Prot

Elbasan, më 05.05.2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.63, datë 28.04.2026 “ Ndryshim financimi në periudhën afatmesme 2027-2028”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





514  
28.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2403/1 Prot.

Elbasan më, 29.04.2026

VENDIM

Nr. 64 datë: 28.04.2026

**“Për një shtesë në VKB nr.157 datë 24.12.2025 “Miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës “Për një shtesë në VKB-në nr.157 datë 27.12.2025 “Miratim dhënie burse, për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026”, mbështetur në nenin 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në VKM-në nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar, në Urdhrin nr.207 datë 24.04.2026 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të marrjes së vendimit për bursat e nxënësve të klasave të 10-ta të arsimit profesional në Këshillin Bashkiak Elbasan dhe Pukë” të MEKI-t dhe me propozim të Komisionit të shqyrtimit të bursave të ngritur me Urdhrin nr.800 datë 01.10.2025 “Për ngritjen e komisionit që do të shqyrtojë kërkesat e nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për përfitimin e bursave për vitin shkollor 2025-2026” të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

- 1- Të miratojë dhënie bursave, për nxënësit e shkollës “Shkolla Profesionale Elbasan”, për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës bashkëlidhur.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, pranë Bashkisë Elbasan.

**Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

Elsid Zyma

**Konceptoi:**

Drejtoria e DAPSHRSMD, K.Lala

Drejtoria e DPKSAPR, D.Rroseni

Drejtoria Juridike, A. Hoxha

Drejtoria BF, A.Merkja

Zv/Kryetar, K.Krasnika

**KRYETARI**


Lutfi Lala



Miratuan me 37 vota  
Pro 33  
Kunder 0  
Abstenim 0

Lista emërrore e nxënësve përfundues burse për vitin shkollor 2025 - 2026, në shkollën "Shkolla Profesionale Elbasan"

Nr	Emer	Atesi	Mbiemer	Institucioni arsimor	Klasa	Dega	Gjimia	Kriteri	Bashkia	Bursa
1	Aleandro	Albert	Serica	SHPE	X	SHMT	Mashkull	2.3/dh Kriteri Joekonomik / Komuniteri rom & egjiptian	Elbasan	E plotë
2	Anxhelika	Gentian	Çepa	SHPE	X	Ekonomik	Femër	2.3/gj Kriteri Joekonomik / Nx Vajza qe ndjekin AP (pervec degeve te plkes F)	Elbasan	1/2 burse
3	Fjordis	Flanur	Kllogjieri	SHPE	XII	Hidroteknik	Mashkull	2.3/d Kriteri Joekonomik / Nx me Prindin me Status invalidi	Gramsh	E plotë
4	Fabion	Xhevahir	Çekoja	SHPE	XIII	Mekanike	Mashkull	2.3/d Kriteri Joekonomik / Nx me Prindin me Status invalidi	Elbasan	E plotë
5	Orjeta	xxx	Çërtku	SHPE	XII	Hoteleri	Femër	2.3/dh Kriteri Joekonomik / Komuniteri rom & egjiptian	Elbasan	E plotë
6	Marjan	Albert	Toçi	SHPE	X	Elektroteknik	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Elbasan	E plotë
7	Albion	Ilirjan	Kumrtija	SHPE	XI	Elektroteknik	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Besh	E plotë
8	Endrit	Skërlajm	Lleshi	SHPE	XI	Elektroteknik	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Çërtik	E plotë
9	Andrea	Admir	Tahiri	SHPE	X	SHMT	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Elbasan	E plotë
10	Orgjio	Luan	Dopi	SHPE	XII	Mekanike	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Elbasan	E plotë
11	Soldo	Levent	Zogo	SHPE	XII	Elektroteknik	Mashkull	2.1/a Kriteri ekonomik / Distanca 5km	Elbasan	E plotë



2403/2

04.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË  
DELEGUARA

Nr. 514/prot.  
1

Elbasan, më 4.5.2026

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit të Nr.64 datë 28.04.2026, "Për një shtesë në VKB nr. 157 datë 24.12.2025, "Miratim dhënie burse, për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional, për vitin shkollor 2025-2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

